


PROCESI I TENDERIMIT



"Kosova e Re" fillon të prodhojë energji elektrike me 2023

PROCESI I TENDERIMIT PËR "KOSOVËN E RE"

Pas një procesi konkurrues dhe të hapur prokurimi në përputhje me kërkesat materiale të rregullave të Bankës Botërore, më 3 maj 2019, investitori ContourGlobal dhe Qeveria e Kosovës kanë njoftuar përzgjedhjen e konsorciumit të kompanive të General Electric si Ofertues të Preferuar në tenderin për Inxhinieringun, Prokurimin, Ndërtimin dhe Mirëmbajtjen Afatgjatë për projektin e Termocentralit "Kosova e Re".

Ky akt i përzgjedhjes së ofertuesit të preferuar i hapë rrugë investitorit ContourGlobal për hapjen e negociatave të mëtejshme me qëllim të arritjes së një marrëveshje mbi kushtet përfundimtare. Qeveria e Kosovës do të ushtrojë të drejtat e saja për pjesëmarrje në procesin e negociatave me qëllim që të sigurojë marrëveshje e cila reflekton interesin e qytetarëve të Kosovës.

Në të njëjtën kohë, investitori ContourGlobal është në proces të finalizimit të financimit të projektit. Paketa përfundimtare e financimit do të aprovohet nga institucionet e Kosovës.

Pas përmbylljes së këtyre etapave do të fillojnë punimet për ndërtimin e Termocentralit "Kosova e Re", ndërsa operimi do të fillojë në vitin 2023.